

De Bellum Essentia

Evoluimi i Konceptit të Luftës në Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Brenton Kotorri

Gusht, 2014.

Përmbajtja:

Kapitulli I : Hyrja.

Kapitulli II: Teoritë shpjeguese të konceptit të luftës.

2.1. Lufta si fenomen midis njerëzve dhe si fenomen midis shteteve.

2.2. Sun Tzu

2.3. Clausewitz.

3. Kapitulli III : Historia e Luftës dhe Lufta në Histori.

3.1. Lufta në Lashtësi, Mesjetë dhe sot.

3.2. Lufta e Peloponezit: Një version i shkurtër, i një historie të gjatë.

3.3. Beteja e Waterloo-së.

3.4. Zbarkimi i aleatëve në Normandi: (Operacioni OVERLORD).

3.5. Operacioni TET në Vietnam.

4. Kapitulli IV : Analizë Krahasimore e konceptit të luftës.

4.1. Sun Tzu: Lufta është si uji.

4.2. Lufta është më shumë sesa një kameleon.

4.3. Prej çfarë përbëhet Triniteti i Clausewitz-it.

4.4. Të dy autorët mbeten njëjloj të rëndësishëm.

5. Kapitulli V : Përfundimet.

Bibliografia

Abstrakt

Ky punim fokusohet tek vëzhgimi i luftës si koncept historik. Lufta është një element boshtor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, dhe një element kyç në rrjedhën e shoqërisë njerëzore të ndarë në shtete. Në analizën shoqërore të luftës, ajo përgjithësisht është konceptuar si vazhdim i një dueli në shkallë më të gjerë. Në aspektin politik të marrëdhënieve ndërkombëtare, lufta është përplasje e qëllimeve dhe/ose interesave të shteteve, e zhvilluar si përplasje fizike konkrete. Kur e analizojmë luftën në dy dimensione, aspekti esencial dhe forma e jashtme, kuptojmë se forma ka ndryshuar vazhdimisht dhe vazhdimisht në varësi të zhvillimit industrial dhe teknologjik të njerëzimit. Ndërkohë esenca/thelbi i saj ka mbetur i njëjtë që prej gjenezës së njerëzimit e deri më sot. Këtë tezë, tezën e aspektit strukturor të thelbit të luftës, (thënë ndryshe, faktin që thelbi i luftës mbetet i ndjetë përtej të gjitha ndryshimeve të jashtme) e kanë mbrojtur më me sukses dy mendimtarë *par excellence*, Sun Tzu dhe Clausewitz. Për ta testuar këtë tezë, në punim parashtrohen katër raste historike të cilat përshkruhen në mënyrë të përmbledhur në funksion të mendimit teorik. Këto raste historike janë përzgjedhur në sajë të epokave të ndryshme dhe për rrjedhojë, stadeve të ndryshme të zhvillimit njerëzor. Në fund të këtij punimi, kuptojmë rëndësinë reale të këtyre dy mendimtarëve jo vetëm për madhështinë teorike të veprave të tyre, por edhe për shkak të vërtetimit të tezës sonë fillestare, se thelbi i luftës mbetet triumfi ndaj kundërshtarit me çdo kusht, dhe se ky variabël nuk ndryshon pavarësisht ndryshimeve teknologjike, industrial, etj.

Kapitulli I : Hyrja.

Përgjatë gjithë historisë së njerëzimit është kuptuar se lufta ka rëndësi kyçe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sot, edhe pse nuk i lejohet një shteti ta përdorë luftën si një mjet për të zgjidhur problemet e veta, (Përveç rasteve të vetëmbrojtjes apo aksioneve kolektive të OKB-së), ajo mbetet një instrument i gjallë në marrëdhëniet mes shteteve dhe një element i rëndësishëm i rendit ndërkombëtar. Kësisoj, lufta mbetet një fenomen shoqëror dhe politik me rëndësi të madhe studimore.

Ky punim synon të vërtetojë se thelbi i luftës mbetet i njëjtë edhe pse luftëbërja dhe mjetet e saj kanë ndryshuar përgjatë historisë. Përtej zhvillimit historik të luftëbërjes, premisat konceptuale të luftës mbeten të njëjta. Lufta përgjithësisht përkufizohet si një gjendje konflikti të armatosur mes dy vendeve, ose midis dy grupeve të ndryshme brenda të njëjtit vend (Concise Oxford English Dictionary eleventh edition).

Sidoqoftë, në shkencat sociale, përkufizimi më i pranuar mbi luftën e përcakton atë si një aktivitet shoqëror i përplasjes së dhunshme midis dy palësh në konflikt. Më specifikisht në disiplinën e marrëdhënieve ndërkombëtare, përkufizimi shkencor më i thjeshtë dhe bazik është ofruar prej Hedley Bull-it kur thotë se: Lufta është një veprimtari e dhunshme e organizuar, e ndërmarrë prej njësisive të caktuara politike, kundër njëra-tjetrës (Bull, 1977: 178.)

. Për të qendruar sa më korrekt brenda të gjitha këtyre përkufizimeve, për hir të qëllimit specifik të këtij punimi, do të propozojmë si premisë përkufizimin e mëposhtëm mbi luftën: *Lufta është një përplasje e dhunshme mes dy entiteteve sikur-shtete.*

Ky përkufizim na ndihmon ta studiojmë luftën të zhveshur nga kontekstet limitues, por si një koncept të përgjithshëm. Gjithashtu, na lehtëson fokusimin vetëm tek përplasjet midis perandorive, mbretërive, principatave, qeverive apo formave të tjera të ngjashme me shtet-kombin, si njësi politike e ditëve tona. Ky fokusim eliminon të gjitha rastet e luftërave

midis individëve, grupeve, shtresave, klasave, racave, apo midis cilado entiteteve të pangjashme me organizimin e mirëfilltë politik që sikurse e thamë sot e quajmë shtet.

Pasi kemi ofruar përkufizimin e përgjithshëm të luftës, për rrjedhojë duhet të analizojmë thelbin dhe formën e luftës në nivelin konceptual. Prandaj, nëse lufta është përplasje e dhunshme mes dy entiteteve sikur-shtete, dhe nëse mbajmë parasysh se cilido qoftë synimi i shtetit në arenën ndërkombëtare, ai mbetet sidoqoftë një synim politik. Pa dashur të kufizohemi tek përcaktimi i famshëm i Clausewitz-it se lufta është vazhdim i politikës ... (Clausewitz, 2010: 41) duhet të kuptojmë gjithsesi se në luftë, të dyja entitetet që përplasen kanë të njëjtin qëllim racional përfundimtar: *Fitoren*. Kështu, po ta çojmë analizën pak më gjatë shohim se thelbi i vërtetë i luftës është arritja e qëllimit politik të shtetit, përmes asgjësimit të shtetit tjetër, ose përmes imponimit të vullnetit të vet mbi tjetrin.

Edhe më qartë, thelbi i luftës, është artikuluar nga Ralph Peters, kur thotë: *Natyra e luftës nuk ndryshon kurrë, ndryshon vetëm manifestimi i saj në sipërfaqe. Joshua dhe Davidi, Hektori dhe Akili do ta njihnin menjëherë betejën që kanë zhvilluar ushtarët dhe Marinsat tanë nëpër rrugicat e Somalisë a Irakut. Uniformat evoluojnë, bronzi zëvendësohet me çelik, shigjetat mund të zëvendësohen me bomba të telekomanduara me lazer, por thelbi është t'i godasësh armiq të e tu deri sa të mbijetuarit të dorëzohen dhe t'i nënshtrohen vullnetit tënd*" (Peters, 2005: 30)

Ky punim do të prezantojë dy prej teoricienëve më të spikatur të luftës, luftëbërjes dhe strategjisë, përkatësisht Sun Tzu dhe Carl Von Clausewitz. Këta teoricienë i përkasin epokave të ndryshme të historisë së njerëzimit. Teoritë përkatëse dhe analizat e rasteve specifike që këta mendimtarë na paraqesin, do të na mundësojnë të kuptojmë si thelbin dhe esencën e brendshme të luftës, ashtu edhe formën e jashtme të luftës, thënë ndryshe luftëbërjen (warfare). Duke pasur këtë kornizë mendimi, do të kemi mundësinë të vëzhgojmë përmbledhtazi disa luftëra tipike të historisë, të cilat jo vetëm që kanë lënë gjurmë në zhvillimin e njerëzimit, por shpesh kanë

shërbyer për të sjellë përmbysje të mëdha shoqërore, politike, apo ekonomike. Duke bërë të mundur shpesh ndryshimin e rrjedhës së historisë.

Do të nisim me Luftën e Peleponezit duke shqyrtuar Betejën e Maratonës për të parë metodat dhe mjetet e luftëbërjes. Do të vazhdojmë me Betejën e Vaterlosë për të kuptuar efektin e armëve të reja në luftëbërje. Më pas do të shqyrtojmë Zbarkimin në Normandi të trupave Aleate gjatë Luftës së Dytë Botërore. Së fundmi Operacioni TET në Vietnam do të na jap mundësinë të vëzhgojmë një luftë të përballjes fizike në epokën Post-Atomike.

Për ta vëzhguar fenomenin e luftës si koncept historik kam zgjedhur qasjen strukturaliste.¹ Qasja strukturaliste e konsideron sistemin si një tërësi të vetme dhe jo si shumësi pjesësh. Ajo gjithashtu implikon se transformimet që ndodhin në sistem nuk udhëheqin drejt daljes nga sistemi, por gjithmonë përforcojnë elementet thelbësore të sistemit dhe ruajnë të pa lëvizura ligjet e këtij sistemi. Kjo metodë përdoret gjerësisht në shkencë, por më së shumti shfaqet në matematikë dhe logjikë (Teori grupi, algjebër e përgjithshme); Fizikë dhe biologji (Modelet strukturore të rastësisë, homeostaza); Psikologji (Ligjet Gestalt, struktura e inteligjencës); Linguistikë (Sinkronika, gramatikë përgjithësuese); Shkenca Sociale (Strukturalizëm analitik, global dhe antropologjik); Dhe filozofi (dialektikë, epistemologji.)

Metodologjia që kam zgjedhur të përdor gjatë punimit, është analiza e burimeve dytësore, duke qenë se fokusi i temës është tashmë i trajtuar gjerësisht dhe thellësisht prej shumë studiuesve të aftë të marrëdhënieve ndërkombëtare. Kjo metodë do të na ndihmojë gjithashtu në analizën e pasvëzhgimit, për të vërtetuar se sa rëndësi ka krahasimi i rasteve historike nën optikën e teorive mbi luftën. Kjo metodë gjithashtu na mundëson të kuptojmë se si lufta ndahet në këto dy dimensione, pra thelb dhe formë. Na lejon të kuptojmë sesi thelbi, si variabël i pavarur, nuk ndryshon me gjithë ndryshimin e variabëlve të tjerë që përbëjnë dhe përcaktojnë formën.

¹ <http://eric.ed.gov/?id=ED059072> Parë për herë të fundit 18/06/2014.

Kapitulli II: Teoritë shpjeguese të konceptit të luftës.

2.1. Lufta si fenomen midis njerëzve dhe si fenomen midis shteteve.

Përgjigja më e famshme dhe më me peshë ndaj pyetjes: Pse ndodh lufta?, është dhënë prej Thomas Hobbes-it. Ai argumenton se përpara se të lindnin qeveritë, njerëzit në Gjendjen Natyrore dominoheshin prej ndjenjave egoiste duke pasur parasysh se jeta ishte vetjake, e varfër, e ndyrë, e shëmtuar dhe shumë e shkurtër.

Kështu, për Hobbes-in, Gjendja e Natyrës është lufta për mbijetesë e të gjithëve kundër të gjithëve. Mbi këtë premisë, ai besonte se bashkëpunimi dhe bashkëjetesa ishte e pamundur në kushtet e mungesës së një autoriteti qendror. Vëzhguesit dhe studiuesit apo edhe aktorët njerëzorë të marrëdhënieve ndërkombëtare, (fillimisht marrëdhëniet midis tribuve/fiseve, më pas marrëdhëniet midis qytet-shteteve, më pas marrëdhëniet midis popujve, më pas marrëdhëniet midis perandorive, më pas marrëdhëniet ndërmjet shteteve-kombe), si ata para edhe ata pas përkufizimit që i bëri Hobbes-i Gjendjes Natyrore, të cilët e besojnë këtë premisë imagjinare, e kanë përkthyer ose aplikuar Gjendjen Natyrore midis njerëzve me një gjendje natyrore tashmë midis shteteve (fiseve, popujve, qeverive, etj). Mund të përmendim më të spikaturit si:

- Thucydides, një historian i Greqisë së lashtë i cili shkroi *Historia e Luftës së Peleponezit* dhe që shpesh citohet si intelektual i qellimit që parashikoi realpolitikën.

- Sun Tzu, një strateg ushtarak i Kinës së lashtë i cili shkroi *Arti i Luftës*.

- Niccolò Machiavelli, një filozof politik fiorentin, i cili shkroi *Il Principe* (Princi-n) ku thoshte se qëllimi i vetëm i një princi (politikani) ishte që të

maksimizonte pushtetin e vet, pa mbajtur fare parasysh norma fetare apo etike.

- Cardinal Richelieu, një shtetar dhe klerik francez i cili i shkatërroi fraksionalizmat e brendshme dhe e udhëhoqi francën drejt një pozite dominuese në politikën e saj të jashtme, pozitë që zgjati disa shekuj.

- Frederick Barbarossa, monarku prusian i cili e transformoi Prusinë në një superfuqi europiane përmes luftëbërjes dhe diplomacisë.

- Charles Maurice de Talleyrand-Périgord, diplomat francez i cili në prapaskenë e udhëhoqi francën dhe Europën përmes një sërë sistemesh politike.

- Princi Klemens Wenzel von Metternich, shtetar austriak i cili e kundërshtonte revolucionin politik.

- Carl von Clausewitz, teoricien dhe general ushtarak Prusian i shekujve 18-19 i cili shkroi *Mbi Luftën (Vom Kriege)*.

- Otto von Bismarck, shtetar prusian i cili gdhendi konceptin Balancë e Fuqisë. Balancë e fuqisë do të thotë të zhvillosh diplomacy dhe realpolitikë duke shmangur garën e ametimeve.

- Vëzhgimi dhe mendimi realist përfshin edhe figura si Hans Morgenthau, apo Henry Kissinger, të cilët kishin qëndrime të kundërta mbi luftën në Vietnam, gjeneralin dhe presidentin francez Charles de Gaulle, si dhe liderin sovjetik Joseph Stalin.

Për Realizmin, sistemi ndërkombëtar karakterizohet nga anarkia, ose ahtu siç thoshte Hobbes-i, mungesa e një autoriteti qendror. Shtetet janë sovranë dhe për rrjedhojë autonome prej njëri-tjetrit. Në një sistem të tillë anarkik, fuqia e shtetit është variabli kryesor dhe në fakt i vetmi me interes. Kjo pasi vetëm përmes fuqisë shtetet do të mund ta mbronin veten dhe të arrinin të mbijetonin. Realizmi njih një shumëllojshmëri fuqish si përshebull: ushtarake, ekonomike, diplomatike etj. Por përgjithësisht

përcakton fuqinë imponuese të shtetit si përcaktuese në politikën ndërkombëtare.

Ky vështrim i botës implikon sikurse thotë Mearsheimer (Mearsheimer, 1994:5). katër pohime: Së pari, realistët pretendojnë se mbijetesa është qëllimi kryesor i çdo shteti. Kjo do të thotë se pushtimi nga një shtet tjetër është e keqja më e madhe me të cilën cilido shtet përballet dhe për rrjedhojë, çdo shtet duhet të maksimizojë fuqinë e vet për të parshikuar çdo rast rreziku. Së dyti, realistët i konsiderojnë shtetet si aktorë racionale. Kjo do të thotë se bazuar tek nevoja jetike për të mbijetuar shtetet do të sigurojnë mjetet dhe mënyrat më të mira të mundshme. Së treti, realistët hamendësojnë se të gjitha shtetet kanë njëfarë kapaciteti luftarak, dhe asnjë shtet nuk mund t'i dijë saktësisht qëllimet e fqinjëve të vet. Me fjalë të tjera bota është e rrezikshme dhe e pasigurtë. Së katërti, në një mjedis të këtillë, janë Fuqitë e Mëdha, (shtetet me aftësitë më të mira ekonomike dhe mbi të gjitha ushtarake) ato që janë vendimtare.

Për ta ilustruar me konkretisht dhe specifikisht shkollën realiste të vëzhgimit në Marrëdhëniet Ndërkombëtare, po sjellim tre prej autorëve jo vetëm të rëndësishëm, por që njëkohësisht janë ndalur edhe më shumë tëk koncepti i luftës. Koncept që përbën edhe pikën e vëmendjes së këtij punimi. Së pari do të shohim shkurtimisht boshtin kryesor të mendimit të Sun Tzu dhe Carl von Clausewitz.

2.2. Sun Tzu

Sun Tzu ishte një strateg dhe gjeneralushtarak kinez i cili shkroi The Art of War (Arti i Luftës) rreth 2 500 vite më parë. Premisat kryesore të këtij libri vlejné për luftërat e çdo kohe. Bukuria e strategjisë që mëson Sun Tzu-ja të ndihmojnë të transformosh konflikte tepër të dizfavorshme. Shumë shpesh, mësimet e Sun Tzu-së aplikohen jashtë sudimeve ushtarake, si përshembull në fushata politike, në në sport dhe sidomos në biznes.

Për sa i takon pikërisht strategjisë, Sun Tzu e nis me “planifikimin” si koncept i cili bazohet mbi vëzhgimin krahasues të strukturave konkurente.

Kështu, përgjatë gjithë veprës, ndërvarësia midis faktorëve kontekstualë të luftës merr të njëjtën rëndësi sa edhe vetë faktorët. Arti i Luftës përshkohet nga një frymë konceptuale sferike, ku asgjë nuk duhet lënë jashtë analizës. Marrëdhënien midis thelbit të luftës dhe formës së zhvillimit të saj, Sun Tzu e paraqet përmes 5 elementeve kryesore të veprës.

- Etika morale (Tao)
- Klima ose koha (Tien)
- Terreni (Di)
- Lidërshipi dhe komanda (Jiang)
- Metoda (Fa)

Tao, që përkthehet si "filozofia" ose "fryma", Është faktori kyç i parimeve të Sun Tzu-së. Klima, nënkupton ndryshimet e mundshme të motit dhe stinëve. Edhe pse në luftë klima është një prej faktorëve më të pakontrollueshëm, një lider ose general i mirë duhet të dijë se si ta përdorë këtë faktor sa më saktë në avantazhin e vet. Ai duhet të zgjedhë kohën më oportune për të luftuar, duke e përdorur motin e keq në një mënyrë të atillë që të jetë sa më e dëmshme për armikun. Terreni është vendndodhja ose fushëbetetja ku zhvillohen operacionet ushtarake. Mirëpo shpesh edhe ky element mund të jetë i pakontrollueshëm, për Sun Tzu-në përgjegjësia bie sërish mbi liderin. Është lideri ai që duhet ta kthejë terrenin e luftës në një avantazh të dukshëm për trupat e veta. Kur flet për lidërshp osë udhëheqje, Sun Tzu-ja nënkupton aftësitë intelektuale dhe praktike që duhet të zotërojë një general. Kjo sepse ai është mishërim i vlerave si kurajoja, dija, dashamirësia she sinqeriteti ndaj trupave të veta si dhe disiplina e korrektesa.

Një lider kurajoz fiton duke i shfrytëzuar pa asnjë hezitim mundësitë që i dalin përpara. Një lider i mençur ka aftësinë për ta kuptuar kur një situatë ndryshon në favour ose disfavour të tij. Nëse është dashamirës, ai ka aftësinë për t'i kuptuar të vetët, dhe për tu bërë empatik ndaj tyre duke vlerësuar kështu dedikimin dhe mundin e tyre. Kur ai shfaq sinqeritet, trupat e veta janë të bandura se do të shpërblehen me drejtësi të lartë. Nëse është korrekt

ai u mëson disiplinën burrave të vet dhe në çdo situatë e ka luksin që të përcaktojë dhe krijojë njësitë e veta organizative. Metoda është elementi që shoqëron gjithçka. I përket çdo oranzate, çdo sistemi, procedure apo strukturimi. Metoda që përdoret në luftë duhet të jetë efektive dhe efikase duke ruajtur koherencën me qëllimin përfundimtar të luftës, dhe duke i qendruar besnike filozofisë ose frymës së saj.

Arti i Luftës është një kombinim i filozofisë së thelluar me përshkrimet e detajuara të taktikave fituese në luftë. Vetë vepra nis me premisën se “Lufta është një çështje me rëndësi jetike për shtetin; hapësira e jetës dhe vdekjes; rruga drejt mbijetesës ose shkatërrimit. Prandaj studimi i saj është i domosdoshëm dhe nuk duhet të neglizhohet”. (Sun Zu, 2010:5). Më tej Sun Tzu-ja shpjegon mënyrat e shpërqendrimit të kundërshtarit dhe bazën e të gjithë luftëbërjes. Për të fituar dhe triumfuar, duhet të hiqesh s ii paaftë ndërkohë që je i aftë, të hiqesh si inaktiv edhe pse je duke vepruar. Nëse je pranë armikut, bëje të mendojë se nuk je fare aty afër. Nëse je larg tij, jepi shkas të mendojë se je shumë afër. Sun Tzu-ja ishte themeluesi i “Qasjes jo të drejtëpërdrejte” si metodë për të fituar luftën. Ai thoshte se kushdo që ia del të kontrollojë si qasjen direkte edhe atë indirekte, do të mund të mbizotërojë në çfarëdo situatë. Sipas Sun Tzu-së, triumfi në cilindo konflikt apo garë vjen si pasojë e një loje të mirë me mundësitë apo probabilitetet.

Sun Tzu-ja na instruktton se për të qenë të sukseshëm, duhen zhvilluar të gjitha aftësitë e kontrollit mbi aspektet e luftës që nuk janë në dorën tonë, dhe duhet t'i kthejmë ato në avantazhin tonë. Sikurse thotë ai: “Ashtu si uji që e eviton të tatëpjetën dhe rrjedh drejt fushave të ulëta, ashtu edhe ushtria duhet ta shmangë forcën dhe të sulmojë dobësinë” (Sun Tzu, 2010:18). Nga ate gjitha këshillat që Sun Tzu ofron në traktatin e tij, dhe nga të gjitha aksiomat që parashtron, mund të kuptojmë se sa i dukshëm është që në fillimet e historisë pikërisht thelbi i luftës.

2.3. Clausewitz.

Kryevepra e Clausewitz-it, *Vom Kriege* (Mbi luftën) është pa dyshim punimi më i rëndësishëm i shkruar ndonjëherë mbi luftën dhe luftëbërjen. Megjithëse *Mbi Luftën* është publikuar më 1832-shin, ajo mbetet një vepër ku referohen me mijëra vepra të tjera të studiuesve socialë, por mbi të gjitha, të studiuesve ushtarakë. Sidoqoftë, këtë vepër më shumë e citojnë sesa e lexojnë dhe kuptojnë (Bassford, 1996:22). Sidoqoftë, këtu, ne nuk do të marrim përsipër të analizojmë këtë *Magnus Opera* por thjesht të bëjmë një përmbledhje të veprës, pasi këtu ndalet edhe fokusi i këtij punimi.

Vegetius, një shkrimtar romak i shekullit 4 P.K, thotë: "Të përgatitet për luftë ai që dëshiron paqe." Carl von Clausewitz e theksoi më shumë këtë pikë: "Fakti që masakrat janë një spektakël i tmerrshëm, duhet të na bëjë ne ta marrim më seriozisht luftën, por nuk duhet të jetë një justifikim që ne gradualisht të mprehim shpatat tona në emër të njerëzimit. Herët a vonë, dikush do të vijë me një shpatë të mprehtë dhe do të na presë krahët."

Clausewitz-i (1780-1831) studioi më shumë se gjithçka luftën totale (Regier, 2009:32). Edhe pse ai nuk dinte gjë për tanke, forca ajrore apo komunikime satelitore, betejat që kishte dëshmuar ia kishin treguar se si luftërat vrisnin, shkatërronin dhe tmerronin popujt. Në studimet e luftës, ekspertiza ka rëndësi të madhe; dhe ai ishte ekspert ocular i çështjes. Në moshën 12 vjeçare, Clausewitz bashkë me dy vëllezërit u rreshtuan si kadetë në ushtrinë e Prusisë. (Me kalimin e kohës, të tre ata u bënë gjeneralë.) Ai luftoi për Prusinë kundër Napoleonit në Jena, u kap, u dërgua në Paris, u shkëmbye dhe u rikthye në detyrë. Kur Prusia u detyrua të bashkohej me Napoleonin për fushatën e tij shkatërrimtare të vitit 1812, Clausewitz dha dorëheqjen dhe luftoi për carin. Në vitin 1815, i bashkuar sërish me ushtrinë prusiane, ai luftoi në Ligny. Në vitin 1818 ai drejtoi Akademinë Ushtarake në Berlin, vend të cilit i përkushtoi 15 vitet e fundit të jetës së tij. Vepra e tij më e madhe, *Mbi Luftën* (tre volume të *Vom Kriege* u botuan, nga viti 1832 në 1843), mbeti e pambaruar prej vdekjes së tij.

Mbi Luftën është vepër e dobishme për këdo që do që të dijë se si mendon një gjeneral dhe për këdo që mendon se arti i luftës aplikohet në një zyrë, një kompani, kolegji ose skuadër. Vetë Clausewitz e krahasoi luftën me tregtinë dhe aleancat me "një marrëveshje biznesi". Me luftërat e tejzgjatura në Irak dhe Afganistan, specialistët e marrëdhënieve ndërkombëtare kanë zbuluar se *Mbi Luftën* është një gur themeli për sa i takon debateve rreth taktikave, strategjive, qëllimeve të luftës dhe përcaktimit të "fitores". Counterinsurgency Field Manual, një vepër e David H. Petraeus dhe James F. Amos, libri që përcaktoi ndryshimet e strategjisë së ShBA-së në Irak, citon vetëm Clausewitz-in kur thotë se: "Akti i parë, më suprem dhe më i gjerë që mund të duhet të vendosë një burrë shteti dhe një komandant... është, të përcaktojë llojin e luftës që ata janë duke filluar; pa e ngatërruar e pa u përpjekur që ta kthejnë në diçka që është e panjohur në natyrën e saj.

Kjo është e para dhe më gjithëpërfshirësja e të gjitha pyetjeve strategjike." "I parë, suprem": Ky është Clausewitz. "Veprat më të mëdha në historinë e luftës nuk mund të parashtrohen në libra" shkroi ai, duke e vendosur luftën në të njëjtin realizëm të ashpër siç vendosi Makiaveli shtetbërjen. Në veprën: Clausewitz's Puzzle: The political theory of war (Oxford University Press, 2007), Andreas Herberg-Rothe, një profesor në Humboldt University në Berlin, argumenton se ajo që e bën të vlefshëm leximin e Clausewitz është analiza e tij e thellë e fushatave të Napoleonit: tendenca e tyre drejt dhunës së pakontrolluar, rëndësia vitale e lidërshiptit, roli i fatit në luftë, roli i politikës dhe i fatkeqësive të një pushtimi si fushata e Rusisë në vitin 1812. Clausewitz-i vetë, studioi luftërat e Frederikut të Madh dhe të Gustavus Adolphus-it ashtu si dhe ato të Napoleonit. Gjenerali Helmuth von Moltke, heroi i fitoreve gjermane në vitet 1864, 1866 dhe 1871, përmend *Mbi Luftën* si një nga tre librat e tij udhëzues (dy librat e tjerë ishin Homeri dhe Bibla). Ato janë studiuar në West Point dhe Sandhurst. Clausewitz e vlerësonte historinë, jepte leksione historie dhe shkroi për të si diçka vitale që i jepte kuptim botës, por kurrë nuk mendoi se historia është mjaftueshëm. Për të studiuar luftën sipas mënyrës së Clausewitz-it, duhet shkruar në luftë

Clausewitz-i ishte një gjeneral, por e shpenzoi pjesën më të madhe të karrierës së tij si një mësues. Ai ishte lektor për një princ, mësues për kadetë, drejtor i një akademie ushtarake dhe një historian i talentuar ushtarak. Ai donte të shkruante një libër luftime të një rendi shumë më të lartë se sa maksimumet dhe manualet ekzistues të kohës, një libër do të kombinonte eksperiencë, shembujt historikë dhe analiza të sakta dhe të qarta. Si një akademik i kujdesshëm, Clausewitz-i rishikoi draftet të librave të tij disa herë. Ai ishte duke rishikuar *Mbi Luftën* kur vdiq nga kolera.

Ai shihet si profeti i blitzkrieg-ut dhe i luftës totale. Clausewitz-i ishte më i shqetësuar për të mbrojtur fragmentimin e Prusisë sesa pushtimin nga fqinjët e fuqishëm si Franca, Austria dhe Rusia. Në balancën e fuqisë së kohës së tij, ai e kuptoi se Prusia ishte një nga kombet më pak të fuqishme. Edhe pse në një vend të vogël, lufta është një subjekt i tmerrshëm. Ai kishte një mënyrë më pozitive të të menduarit dhe arriti të jetë i suksesshëm aq shumë sa që dijetari francez, Raymond Aron, e pagëzoi me emrin "filozofi i luftës". Mbi Luftën u bë libri i luftës në Gjermaninë e bashkuar dhe u përfshi në të gjitha anët e debatit ushtarak. Arriti dinjitetin më të lartë. Aron vëzhgoi se "Mund të gjesh çfarë të duash në Traktat: Gjithë ajo që të duhet është një selektim citimesh, të mbështetura nga paragjykime personale"². Në vitin 1943, bombarduesit e Aleatëve hodhën fletushka mbi Gjermani ku shkruhej se Hitleri duhet të kishte lexuar Clausewitz-un me më shumë vëmendje. Hitleri u përgjigj në vitin 1944, në një parathënie të Vom Kriege, duke akuzuar të tjerët për keqkuptimin ndaj tij. Hitleri tha: "Bah. Clausewitz-i shkroi se edhe pas një humbjeje heroike, rindërtimi është gjithmonë i mundur. Vetëm frikacakët dorëzohen." Clausewitz në fakt, paralajmëroi: "Fuqia e karakterit mund të degjenerojë në kokëfortësi... një e metë e temperamentit." Fletushkat kishin të drejtë. Hitleri duhet ta kishte lexuar me më shumë vëmendje Clausewitz-in. Duke theksuar se gjenialiteti "është mbi të gjithë rregullat", Clausewitz i apelon sqimës së kujtdo lexuesi. Si të gjithë mendimtarët e mendimeve të thella, ai e përçmonte rutinën: Ai donte të të mësonte se si të

² <http://chronicle.com/article/The-Essence-of-War-Clausewitz/47498/> parë për herë të fundit më 7 korrik 2014.

mendoje. Mbi Luftën, tërheq mendimet e mendimtarëve të tjerë. Studiuesit kanë krahasuar veprën e Clausewitz me veprat e Hegel, Kant dhe Max Weber.

Mbi Luftën është i pasur në slogane të gjalla dhe të paharrueshme. Për shembull: "Karakteri i betejës, ashtu si emri i saj, është masakra"; "E vërteta në vetvete nuk është e mjaftueshme për t'i vënë njerëzit në veprim." Apo "Agresori është gjithmonë paqe-dashësi." Konceptet dhe frazat e *Mbi Luftën* nuk duhet lihen jashtë vëmendjes. Ende sot kanë vlerë elementet e trinitetit të Clausewitz-it - dhuna fillestare, urrejtja dhe armiqësia. Ende sot ne mund të kuptojmë se Mbi luftën, nuk është më ekskluzivitet vetëm i oficerëve dhe veteranëve ushtarakë. Kjo vepër tërheq historian, filozofë, politologë, e madje edhe ekonomistë e biznesmenë. Thënia qendrore e Clausewitz-it, "Lufta është vazhdimi i politikës me mjete të tjera", mbetet shtylla qendrore në debatet për vetë rëndësinë e kësaj vepre. Sidoqoftë Clausewitz-i shkruan se "Çdo epokë ka llojin e vet të luftës, limitet e veta, dhe konceptimet e veta. Prandaj çdo kohe i duhet teoria e vet mbi luftën". Kjo duket se e shpëton Clausewitz-in si parashikues të kohërave transformuese që do të vinin më pas.

Kapitulli III : Historia e Luftës dhe Lufta në Histori

3.1. Lufta në Lashtësi, Mesjetë dhe sot.³

Shumica e historisë së lashtësisë është në fakt vetë historia e luftës dhe ushtrive: Pushtimet e ushtrive, lëvizjet dhe strategjitë e tyre si dhe përmirësimet në teknologji. Kjo lloj congruence bëhet edhe më e qartë po të mbajmë parasysh se mretëritë dhe perandoritë, të cilat ishin edhe entitetet e vetme sikur-shtete në lashtësi, mund të mbaheshin në këmbë vetëm përmes forcës ushtarake.

Në lashtësi, Egjipti nisi të rritej si një fuqi e madhe, por që më pas ra nën pushtimet e Libianëve, Nubianëve, Asirëve, Përsëve, Grekëve, Romakëve, Bizantëve dhe Arabëve. Lufta më e hershme në Indi, për të cilën janë mbajtur kronika, është lufta e Dhjetë Mbretërve. Aleksandri i Madh gjatë një fushate luftërash që zgjati 10 vjet, arriti të pushtonte një hapësirë gjeografike që shtrihej nga Ballkani Lindor e deri në Veri-Perëndim të Indisëku edhe mposhti mbretin Porus.

Në Kinën e lashtë, pas shkëlqimit dhe rënies së dinastive Shang dhe Zhou erdhi një periudhë e gjatë lufte të vazhdueshme mes shtetesh të vogla. Gjatë kësaj kohe edhe Sun Tzu shkroi veprat e tij mbi luftëbërjen si dhe diplomacinë, mirëpo të tjerë mendimtarë të kësaj kohe, ndihmuan në ndërtimin për herë të parë të mjeteve të reja luftarake si Shkalla e Reve (Cloud Ladder), që shërbente për të ngjitur muret e larta të qyteteve ose kështjellave dhe që u përdor deri në fundin e Mesjetës.

Perandoria Perse u themelua nga Sirusi i Madh pasi pushtoi Perandorinë Mediane, Babilonië , Lidian dhe Azinë e Vogël. Pasuesi i tij Cambyses-i pushtoi më pas Perandorinë Egjiptase një pjesë të madhe të Azisë Qendrore, pjesë të mëdha të Greqisë dhe Indisë, si dhe Libinë e gjithë kjo

³ Të gjitha të dhënat historike të kësaj pjese janë të bazuara tek vepra e John Keegan, A history of Warfare PDF version. Shpesh janë bërë përkthime besnike të fjalive për të ruajtur saktësinë e transmetimit.

perandori ra më pas në duart e Aleksandrit të Madh, pasi ai mposhti Dariusin III.

Në Greqi lulëzuan disa qytet-shtete, duke përfshirë këtu Athinën dhe Spartën. Grekët penguan me sukses dy pushtime nga persianët, së pari në betejën e Maratonës, ku persët udhëhiqeshin nga Dariusi i Madh, dhe më pas në betejën e Salamineve. Një betejë që u zhvillua në pjesën më të madhe në det ku grekët nën drejtimin e Themistokliut u përballën me flotën e Kserksit. Më pas për grekët erdhi Lufta e Peleponezit e cila çoi edhe në shkatërrimin e Spartës.

Ndërkohë Roma po grumbullonte fuqi pas një beteje të fituar ndaj Etruskëve. Gjatë kohës që pasoi, romakët mposhtën në Luftërat Punike fuqinë fqinje të Kartagjenës. Lufta e Parë Punike u përqendrua tek luftëbërja detare. Lufta e Dytë Punike nisi me pushtimin e Italisë nga Hanibali i cili i rrethi romakët nga Alpet dhe e mbylli fitoren në betejën e Cannae-së. Ai sidoqoftë u detyrua të kthehej në Kartagjenë ku humbi betejëne Zamas kundër Scipio-s, komandantit romak i cili i dha fund Kartagjenës si fuqi ushtarake në Luftën e Tretë Punike. Pasi mundën Kartagjenën u shndërruan në fuqinë dominuese të Mesdheut duke arritur suksese në Greqi, në Lindjen e Mesme, në Francë dhe ndaj disa fiseve gjermanike. Roma mundi të qendronte si fuqia ushtarake predominuese edhe në sajë të trainimit të egër ushtarak, të superioritetit strategjik, taktik dhe teknik, organizimit si dhe aftësisë së popullit për të përballuar humbjet njerëzore në beteja.

Pas përdorimit të karrocave në luftë, u shpikën armët e zjarrit ose armët me barut. Kjo teknologji e re u përdor për herë të parë në Kinë për llogari të dinastisë Song, por shumë shpejt u përhap në Perandorinë Osmane, Perse, Indiane, në Afrikë, etj. Përdorimi i armëve të zjarrit dhe fuzhnjave me tripod, e zvogëloi si dobinë, ashtu edhe prestigjin e mburojave të çelikëta që përdornin kalorësit e dikurshëm të shpatave dhe luftës së drejtëpërdrejte.

Periudha kohore nga 1648-a, Paqja e Vestfalisë e deri më 1789-ën tek Revolucioni Francez, njihet ndryshe edhe si *Kabinettskriege* (Lufta mes Princërve). Kjo pasi lufta nisi të zhvillohej vetëm prej princërve dhe monarkëve

të shteteve të ndryshme mbretërore apo perandorake. Thënë ndryshe, vetëm princërit e kishin të drejtën për të deklaruar luftë. Kjo lloj luftime ishte pa dyshim e kufizuar në mjete (për shkak të nderit kalorsiak) dhe gjithashtu në qëllime (qëllime kryesisht politike, por shpesh edhe ruajtje prestigji). Këto luftëra përfshinin kryesisht mercenarë dhe bazoheshin tek aleancat e ndryshueshme. Përgjatë shekujve të 18-të dhe 19-të, mjetet dhe shërbimet ushtarake kaluan në disa zhvillime me peshë. Tendencat shkoi drejt një artilerie tokësore të lëvizshme, si dhe përdorimi më elastic i këmbësorisë. Këmbësoria tashmë do të përdorte pushkë personale dhe jo më bajoneta të përplasjes trup më trup. Kjo i dha fund edhe përdorimit të Mosketave, për të cilën duhej një ushtar asistent në mbushje. Tashmë kalorësia ishte e përzierë me këmbësorinë për sa i takon përdorimit të armëve.

Kjo epokë i hapi rrugën edhe fillesave të para të industrisë së luftës. Duke qenë se armët e vogla dhe personale u bënë gjithnjë e më të lehta në përdorim, shtetet filluan të mos mbështëteshin më vetëm tek ushtarët profesionistë, por hapën metodën e regjistrimeve dhe rekrutimeve qytetare. Tashmë avancimet teknologjike morën një rëndësi të veçantë. Regjistrimi i qytetarëve të thjeshtë në rradhët e ushtrive, nxiti prodhimin në masë të armëve të zjarrit dhe paisjeve të tjera luftarake. Kjo metodë rekrutimi u përdor pa limite nga Napoleon Bonaparte gjatë Luftërave Napoleoniane. Shtimi i numrit të personelit ushtarak dhe ushtarëve në përgjithësi nxiti edhe idenë strategjike të luftës totale. Thënë ndryshe, shkatërrimin e kundërshtarit deri në masën kur ai e ka të pamundur të përgjigjet ushtarakisht.

Në kohën moderne, mjetet e luftës filluan të ndërtoheshin sipas filozofisë: Fitorja është më e rëndësishme sesa mënyra e luftimit. Kështu, përshembull, koncepti i Luftës Totale është ekstremiteti i këtij trendi të ri. Ushtritë moderne kanë shvilluar teknologji aq të avancuara saqë kanë sfiduar edhe vetë shkencën dhe cilëndo fushë tjetër të dijes.

Duhet theksuar sidoqoftë se ushtritë moderne përfitojnë nga zhvillimi i këtyre teknologjive përmes financimit nga taksapaguesit qytetarë. Jo më si dikur, prej mbretërve në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Për sa i takon Luftës Totale, duhet thënë se ky koncept nuk është ekskluziviteti i epokës post-

atomike, por e hasim që tek format e para të genocidit si përshembull tek përplasjet midis tribuve apo fiseve primitive. Ajo që i dallon ushtritë e ditëve tona, prej ushtrive të kohëve të mëparshme, nuk është pra vullneti për të mbizotëruar në përplasje me çfarëdolloj çmimi, por varieteti teknologjik i mjeteve dhe metodave që udhëheqësit luftarakë kanë në dispozicion. Duke nisur që nga nëndetëset e deri tek satelitët transmetues, apo që nga thikat e xhepit e deri tek silurët ajrorë. Disa prej njësive dhe teknologjive të zhvilluara në kohën moderne, e që i trashëgojmë edhe sot, janë:

- Municionet
- Mburojat e blinduara
- Shërbimi i detyruar ushtarak
- Granatëhedhësit
- Inxhinierët e vendosjes dhe çmontimit të minave.
- Marina
- Aviacioni
- Pushkëtarët
- Njësitet speciale
- Ushtarët marinarë / Marinsat
- Rrjeti global i informacionit
- Superkompjuterat
- Lufta kozmike
- Avionët pa pilotë
- Lufta kibernetike etj.

Lufta e Parë Botërore nisi pas vrasjes së Arkidukës Franz Ferdinand, gjë që çoi në mobilizimin e Austrisë dhe Serbisë. Gjermania iu bashkua

Austrisë për të krijuar kështu Bllokun Qendror; Francezët, britanikët dhe rusët formuan Forcat Aleate. Pas betejës në Marne dhe “Garës në dete”, vijoi zinxhiri i betejave të përplasjes ballë për ballë duke e kyçur kështu luftën në një rrugë pa kthim. U zhvilluan disa operacione madhore prej gjermanëve në betejën e Verdunit dhe më pas disa operacione të britanikëve dhe francezëve në betejën e Somme-së. Në këto ngjarje, për herë të parë u përdorën tanket luftarakë dhe gazi klorinë. Pas hyrjes së Sh.B.A dhe B.S në luftë, gjermanët, dhe blloku qendror u mposhtën.

